

GREEN COAST SH.P.K.

RRUGA "TISH DAIJA", KOMPLEKSI KIKA 2, GODINA 3, KATI 1., TIRANE, SHQIPËRI

L41329038D

VENDIM

I

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më 24.09.2025, në orën 10.00, në selinë e Shoqërisë **Green Coast Sh.p.k.** (më tej referuar si "Shoqëria"), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

- **Shoqëria Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar pranë Regjistrat Tregtar me numër unik të identifikimit të subjektit K72223031K, përfaqësuar rregullisht nga Znj. Edlira MUKA, shtetase shqiptar, lindur më datë 03.02.1983, në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me Nr. 0342771384 (dhe me nr. Personal: I35203147R), madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, (këtu e në vijim referuar si "**Ortaku i Vetëm**").

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton z. Bers Hado, i cili pranon, të kryejë funksionin e sekretarit.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaroi vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaroi Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

RENDI I DITËS

I. ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË

Në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës, Kryetari parashtroi se kapitali aktual i Shoqërisë është **4.687.725.328,00 LEK (Katër miliardë, gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë milion, e shtatëqind e njëzet e pesë mijë, e treqind e njëzet e tetë lekë).**

Në kushtet kur veprimtaria e Shoqërisë ka përformuar kënaqshëm dhe situata financiare është në përputhje me pritshmëritë, është propozuar nga ana e Ortakut të Vetëm zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë në vlerën prej 370,000 Euro (treqind e shtatëdhjetë mijë euro), e barasvlerëshme me shumën në LEK 35,827,100 (tridhjetë e pesë milion, e tetëqind e njëzet e shtatë mijë, e njëqind lekë).

Pas një vlerësimi të kujdesshëm, Asambleja:

VENDOS:

- A. Miratimin e zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë me vlerën 370,000 Euro (treqind e shtatëdhjetë mijë euro), e barasvlereshme me shumën në LEK 35,827,100 (tridhjetë e pesë milion, e tetëqind e njëzet e shtatë mijë, e njëqind lekë) sipas kursit të këmbimit 96.83 të publikuar nga Banka e Shqipërisë në datë 24.09.2025.
- B. Bazuar në sa më sipër zvogëlimi i kapitalit do të konsiderohet Kontribut ne Para dhe i shlyer plotësisht nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.
- C. Si rezultat i miratimit të Zvogëlimit të Kapitalit sipas pikave (A) dhe (B) më sipër, kapitali i Shoqërisë nga 4.687.725.328,00 LEK (Katër miliardë, gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë milion, e shtatëqind e njëzet e pesë mijë, e treqind e njëzet e tetë lekë), bëhet 4,651,898,228.00 LEK (katër miliardë, gjashtëqind e pesëdhjetë e një milionë, tetëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë, dyqind e njëzet e tetë lekë).

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 10.30.

Ky procesverbal i Asamblesë së Ortakut të Vetëm të "Green Coast" sh.p.k mbahet në formën e procesverbalit, në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

**ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË
GREEN COAST SH.P.K.**

Ortaku i Vetem

"Balfin - Balkan Finance Investment Group" Sh.p.k.,

KRYETARI

Znj. Edlira MUKA



SEKRETARI

Z. Bers Hado